



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 19/18
Prishtinë, më 14.3.2018, në orën 11:45
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti, Fikrim Damka, Dardan Molliqaj dhe Jelena Bontiq.

Mungoi: Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Emrush Haxhiu, drejtor i Departamentit të Administratës së Kuvendit të Kosovës; dhe Istret Azemi, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa i Administratës së Kuvendit të Kosovës.

Pjesëmarrës tjerë: Shqiponjë Osmanaj, gazetare në RTK; Drita Vitia, gazetare në Radio Kosova; Albulena Avdiu, gazetare në Ekonomia sot; Safet Berisha, auditor në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Rejhane Zylfijaj, eksperte në GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurie Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, kryetar i komisionit (tutje: kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur të komisionit, më dt. 7.3.2018;**
- 3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues rreth pagave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
- 6. Miratimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projektligjin nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080;**
- 7. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2019-2021;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua unanimisht, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.3.2018

Kryetari konstatoi se komisioni miratoi unanimisht procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7.3.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues rreth pagave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetari, tha se siç kemi paralajmëruar edhe më herët në komision, por edhe në seancë plenare, me rastin e miratimit të taksës operacionale për Trustin, kemi premtuar publikisht se do t'i rishikojmë pagat e Menaxhmentit të Trustit, sepse e konsiderojmë se pagat e tilla janë disproporcionale me nivelin ekonomik dhe social në vend, dhe mbi të gjitha, janë disproporcionale edhe me institucionet tjera financiare, që janë në rang më të lartë se Trusti Pensional. Për këtë çështje, ne kemi themeluar një grup punues në komision, të cilin e ka udhëhequr deputeti Naser Osmani, të cilit ia dha fjalën për të paraqitur raportin e grupit punues.

Naser Osmani, tha se në bazë të vendimit të komisionit, që jemi ngarkuar si grup punues, lidhur me shqyrtimin e mundësisë së korigjimeve të pagave për Trustin, ne kemi menduar që do të ishte shembulli më i mirë që të marrim për krahasim nivelin e pagave me të punësuarit në Bankën Qendrore të Kosovës, meqenëse BQK është po ashtu i njëjti institucion që merret me qarkullimin financiar, si dhe mbikëqyrë Trustin. Ne jemi përqendruar për pozitat që kanë të bëjnë me menaxhmentin e lartë, menaxhmentin profesional dhe me drejtorët.

BQK na ka dërguar nivelin e pagave për të punësuarit, sipas kërkesës sonë, përderisa paga e guvernatorit është 4,140 euro dhe paga e zyrtarit të lartë është 1,075 euro, me të tjerët nuk jemi marrë, meqenëse kanë pagë më të ulët se 1,000 euro. Edhe Banka Qendrore, edhe Trusti Pensional, të punësuarit nuk i konsiderojnë si shërbyes civilë, sepse me ligj dhe rregullore të tyre e kanë të përcaktuar statusin e tyre. Pas kërkesës, Trusti Pensional e ka dërguar shkresën dhe kanë dhënë edhe sqarime lidhur me shtesat dhe me pagat që marrin, që realisht konsiderohen të larta. Paga e drejtorit në Trustin Pensional është 4,980 euro, paga më e ulët është 1,150 euro e zyrtarit për marrëdhënie me publikun, pastaj pozitave tjera që sillen mbi 1000-2000 euro.

Rekomandimi i grupit punues është që t'i drejtohem i Bordit Drejtues, sepse është organ i cili e përcakton, sipas rregullores, pagën e menaxhmentit dhe stafit të Trustit. Rekomandimet e grupit punues janë këto:

- Të zvogëlohet paga për 25%, në të gjitha pozitat e menaxhmentit të lartë, stafit profesional dhe drejtorëve;
- Të hiqen shtesat e anëtarëve të Bordit për pjesëmarrje në mbledhje (përveç pagës kanë edhe shtesë për çdo mbledhje);
- Heqjen e kontributeve vullnetare të Bordit Drejtues dhe të të punësuarve për 5% (këtë e kemi bërë që të verifikohet, nëse është proporcionale pagesa e punëdhënësit dhe e punëmarrësit, ku nëse është proporcionale, do të kemi një tolerim që ta lejojmë, mirëpo nëse paguhet më shumë punëdhënësi se sa punëmarrësi, atëherë kjo duhet të korigjohet);
- Heqjen e të gjitha shtesave dhe bonuseve të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale.

Propozimi është që të miratohet kjo dhe në emër të komisionit t'i dërgohet Bordit Drejtues. Në qoftë se Bordi nuk e merr në konsideratë propozimin e komisionit, atëherë ne do t'i rekomandojmë Kuvendit që të korrigojë apo zvogëlojë taksën operationale, e cila do të bënte zbritjen për zvogëlimin e këtyre pagave, shtesave dhe kompensimeve tjera, aq sa ne e kemi konsideruar të nevojshme.

Kryetari, theksoi se pagesa e Menaxhmentit të Trustit është përtej niveleve më të larta financiare të organizatave tjera, në këtë rast, Bankës Qendrore të Kosovës, e cila do të duhej të ishte institucioni më i lartë financiar në vend. Rekomandimi në lidhje me heqjen e shtesave është shumë i nevojshëm, dhe siç kemi kërkuar, çështja e pagave duhet të rregullohet dhe nivelohet me ligjin e veçantë për paga.

Naser Osmani, tha se dua të jap një sqarim në lidhje me 25% e pagave, ku paga e këtyre kategorive të menaxhmentit barazohet me nivelin e parë në Bankën Qendrore.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se sa herë që të merren vendime apo të jepen rekomandime për zvogëlimin e pagave, kuptohet që janë të ndjeshme, ku do të pasojnë reagime në raste të tilla. Mirëpo, në të kaluarën, kemi pasur reagime nga të tjerët, në raport me pagat e këtij institucioni dhe ajo që ne na ka shtyrë që të formojmë këtë grup punues, është debati që është zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në lidhje me pagat e Fondit të Kursimeve Pensionale, do të thotë ka pasur kërkesa drejtuar komisionit tonë, që ne të bëjmë një hap në raport me pagat e këtyre të punësuarve.

Ne jemi të vetëdijshëm që këto institucione, si BQK dhe Fondi Pensional, kudo në vendet e zhvilluara kanë paga më të larta se institucionet tjera, andaj reagimi ynë nuk duhet të jetë shumë i madh, nëse i krahasojmë këto dy të fundit, sepse e dimë që kanë një punë më specifike dhe më të ndjeshme. Fondi Pensional i menaxhon mjetet e të gjithë qytetarëve, prandaj ne duhet ta mbajmë nën kontroll, meqenëse i raporton Kuvendit, mirëpo njëkohësisht të kemi kujdes në lidhje me mënyrën sesi po funksion ky institucion.

Më tutje, Hadërgjonaj pyeti anëtarët e grupit punues, lidhur me rekomandimin nr. 5, për heqjen e të gjitha shtesave, kompensimeve dhe bonuseve të të punësuarve të Fondit, konkretisht se çfarë janë shtesat që marrin këta të punësuar në Fond?

Ali Lajçi, theksoi se do të duhej që karshi këtyre që thatë, të bëhet një trysni me miratimin e ligjit për paga, për nivelimin e tyre, por edhe në nivel të Qeverisë. Edhe te Bordi i KOSTT-it, që ishte më herët, kemi konstatim se kanë miratuar 6 muaj paga, pa bazë ligjore, andaj shtesat dhe mëditjet në lidhje me takimet e tyre i konsideroj të panevojshme.

Naser Osmani, theksoi se çështja e bonuseve është ajo që Trusti ka paraparë, nëse ndonjë i punësuar ka performancë të mirë gjatë vitit, atëherë me një vendim të Bordit mund të ndahet edhe një lloj shpërblimi për punëtorë, deri në nivelin maksimal të një page që e kanë, e nga ana tjetër, Trusti ka vazhdimisht performancë pozitive, andaj ne kemi rekomanduar që të hiqet.

Kryetari, tha se ju e keni përpara rekomandimin e grupit punues. Unë propozoj që të miratojë atë dhe t'i dërgohet Bordit Drejtues dhe do të presim 7 ditë përgjigje nga Trusti, për të marrë vendimin për rregullimin e pagave. Në rast se një gjë e tillë nuk ndodh, ne do ta procedojmë këtë rekomandim në seancë dhe do të rekomandojmë që të ndryshohet taksa operationale, konform këtij rekomandimi.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

- I. I rekomandohet Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, që të marrë vendimet në lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, si vijon:

1. Zvogëlimin e pagës për 25%, për të gjitha pozitat e menaxhmentit të lartë, stafit profesional dhe drejtorëve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
2. Heqjen e shtesave të anëtarëve të Bordit Drejtues të FKPK-së, për pjesëmarrje në mbledhje.
3. Heqjen e kontributeve vullnetare të Bordit Drejtues të FKPK-së për +5% (nëse nuk është proporcional në mes të punëtorit dhe punëdhënësit).
4. Heqjen e kontributeve vullnetare për të gjithë të punësuarit në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (nëse nuk është proporcional në mes të punëtorit dhe punëdhënësit).
5. Heqjen e të gjitha shtesave dhe kompensimeve/bonusve të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

II. Bordi Drejtues i FKPK-së, të njoftojë me shkrim Komisionin për Buxhet dhe Financa, për marrjen e vendimeve në lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas Pikës I të këtij rekomandimi, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh.

III. Në rast se Bordit Drejtues i FKPK-së nuk i merr vendimet në lidhje me pagat, shtesat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas Pikës I të këtij rekomandimi, Komisioni për Buxhet dhe Financa do t'i rekomandojë Kuvendit, zvogëlimin e taksës operationale, në pajtim me rekomandimet e bëra.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetari, theksoi se Projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore dhe rekomandoj që ta përkrahim atë dhe ta procedojmë me rekomandim, më tutje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe amendamentet e Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari, theksoi se Projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore dhe rekomandoj që ta përkrahim dhe ta procedojmë më tutje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

6. Miratimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projektligjin nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080

Kryetari, tha se raporti me amendamente, si komision që kemi bërë, ka kaluar nëpër të gjitha komisionet tjera të përhershme dhe janë plotësuar kushtet procedurale, që ta procedojmë projektligjin me amendamente për shqyrtim të dytë në Kuvend. Po ashtu, propozoi që të miratojë raportin final me rekomandime dhe të procedohet në Kuvend.

Kryetari konstatoi se komisionit, me shtatë vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, miratoi raportin me rekomandime, lidhur me Projektligjin nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080, dhe të njëjtin ta procedojë për shqyrtim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2019-2021

Kryetari, tha se në lidhje me këtë çështje, ne kemi formuar një grup punues, në përbërje nga deputetët, Blerim Kuçi dhe Ali Lajçi.

Emrush Haxhiu, tha se siç jeni në dijeni, ne kemi pasur takim me grupin punues, me të cilin kemi dhënë sqarimet dhe diskutimet e nevojshme, ndërkaq grupi punues është pajtuar që KASH-i i Kuvendit, të procedohet më tutje në komision, për procedurat tjera. Krahasuar me kornizat e mëhershme, nevojat e Kuvendit janë më të ulëta sesa në vitet e kaluara. Po ashtu, vlen të theksohet se ka rënie të planifikimeve buxhetore për disa kategori, siç është kategoria e pagave, kategoria e investimeve kapitale dhe e subvencioneve.

Ali Lajçi, theksoi se sa i përket pagave, kjo ishte një ecuri e njëjtë sipas tabelave dhe e arsyeshme me ecuritë tjera. Prandaj, ne jemi dakorduar këtu, me ndonjë ndryshim që mund të rrjedhë më pas, në kuadër të mundshëm të plotësimit dhe planifikimeve, siç janë ato të Ministrisë së Financave.

Naser Osmani, tha se meqenëse ne e miratojmë dhe në mënyrë të veçantë e diskutojmë buxhetin e Kuvendit, dua ta di se çfarë nënkupton me subvencionet, ku dhe si duhet të financohen paratë përmes subvencioneve?

Emrush Haxhiu, sqaroi se dhënia e subvencioneve bëhet në bazë të një rregulloreje që ka miratuar Kryesia e Kuvendit dhe kryesisht iu jepen organizatave, si dhe njerëzve që eventualisht kanë pasur ndonjë fatkeqësi natyrore apo organizatave, që janë jofitimprurëse apo edhe në rast të vdekjes së një deputeti. Këto subvencione vendosen gjithmonë me vendim të Kryesisë së Kuvendit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2019-2021 dhe të kërkohet nga Ministria e Financave, që e njëjta të inkorporohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2019-2021.

8. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit, se më 23.3.2018, në këtë sallë, nga ora 9:00-10:30, do të mbahet një takim në mes komisionit dhe një misioni të FMN-së, që do ta vizitojë Kosovën.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit.

Kryetar i komisionit,

Lumir Abdixhiku